



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1484 Prot.

Tiranë, më datë 12.10.2021

VENDIM
Nr. 599, datë 12.10.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.10.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e relacionit të verifikimit në terren në kuadër të disa gjetjeve arkeologjike të zbuluara gjatë monitorimit arkeologjik gjatë zbatimit të projektit “Pusi vlerësues Shpirag 5, brenda blloqeve 2-3 të studimit, në zonat D”, me subjekt “Shell Albania Block 4 B.V”, hartuar nga DSHA në IKTK;
2. Të realizohet gërmimi shpëtimit arkeologjik në zonat ku janë zbuluar gjetjet rastësore, pranë gjurmëve të strukturave të mureve sipas metodologjisë së përcaktuar në rregulloren e kriterëve të ushtrimit të profesionit të arkeologut, të miratuar me Vendimit Nr. 2, datë 30.01.2009 të KKA
3. Subjekti zhvillues “Shell Albania Block 4 B.V” të lidh akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, për kryerjen e gërmimit arkeologjik të shpëtimit;
4. Rezultatet e gërmimit të paraqiten për vendimmarrje në KKTKM;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

